

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.24.12.2019, (e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
4. Themelimi i Komisionit komunal për hartimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për themelimin e Ansambllit komunal të Qytetit të Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së DBZHR-së, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në Mazgit, për ndërtimin e një çerdheje publike me fonde të BE-së
7. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të shkollës së gjimnazit "17 Shkurti"
8. Shqyrtimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari" objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për Propozim vendimin për tatimin në pronë për vitin 2020
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.19.11.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Prezent: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Qendresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Lendita Bekteshi Memisi, drejtoreshë e ad.së përgj. Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Vlora Mjekiqi Kabashi, drejtoreshë DSHMS-së, Ilire Kelmendi Shema, drejtoreshë e DKRS-së, Bejtullah Mjekiqi, drejtor për bujqësi dhe zhvillim rural, e Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, Drita Hashani, zyrtare ligjore, Myrvete Paloji, kordinatore për integrim, përf.e OSBE-së, përf.i IZHL

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari”, objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
4. Shyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar 2019-2022
5. Shqyrtimi i draft Statutit të Komunës së Obiliqit
6. Raporti i komisionit komunal sipas vendimit :Nr.I-170
 - a) Raporti me nr. X-1054 te datës 04.11.2019
 - b) Raporti me nr X-1087 të datës 11.11.2019
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzërit nga të pranishmit,

1. Pika parë e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

2. Pika dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Pika tretë e rendit të ditës

Kryesuesi – Tani, e kemi draft Rregulloren, për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari”, objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq, e cila duhet të dalë në debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimitisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari”, objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq.

4. Pika katërt e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën për shyrtimin dhe dhënien në diskutim publik të draft planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022. ZKKK-ja, është mirë të na sjellë një raport për planin paraprak, dhe këtë plan, nurmin e të riatdhesuarve, në mënyrë që kur të aprohet ky plan të kemi informacion.

Myrvete Paloji – Paraqet vërejtje në përpilimin e rendit të ditës sepse plani komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar nuk është për periudhën 2019-2020, por 2019-2022.

Kryesuesi - Kërkojmë falje për këtë gabim teknik sepse edhe vet dokumenti është për periudhën 2019-2022.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju e dini se me vendim të Kuvendit komunal e kemi formuar Komisionin për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës dhe për këtë fjalën e ka Drita Hashani, Kryetare e Komisionit.

Drita Hashani – Kuvendi komunal sipas vendimit I-64, të dt.25.04.2019, ka formuar Komisionin prej 7 anëtarëve, i cili ka mbajtur disa takime dhe është munduar të japë kontributin e vet. Për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, Komisioni disa herë iu ka drejtuar Drejtorive komunale, përmes emailit zyrtar për të paraqitur propozimet e tyre, të cilat propozime Komisioni është munduar ti inkorporoj në Statut, aty ku ka pasë vend dhe nuk ka qenë në kundërshtim me ligjin. Draft Statuti i Komunës, ka dalë në diskutim publik me dt.8.09.2019 dhe në bazë të njoftimit është caktuar edhe data e mbajtjes së takimit me qytetarë. Takimi me qytetarë është mbajtur me dt.2.09.2019 dhe gjatë debatit në kemi pranuar disa propozime të cilat Komisioni i ka shqyrtuar dhe ato që ishin në kundërshtim me ligjin i ka refuzuar.

Kryesuesi – Ju njoftoj se kërkesa për ndryshim dhe plotësim të Statutit, ka qenë për shkak të adresës sepse Komuna e vjetër ka qenë në rr.”Hasan Prishtina” ndërsa tani jemi në rr.”Adem Jashari” që gjithsesi duhet me pasë numër.

Drita Hashani – Në web faqe të Komunës, ishte numri 2, por në gjeoportali nuk kam mund me gjetë.

Kryesuesi – Kjo çështje duhet të sqarohet me DSHPE-në dhe DPUKP dhe numri gjithsesi duhet të vendoset.

Drita Hashani - Ne ju kemi drejtuar edhe MAPL-së, në bazë të Rregullores së re që kërkohet për shqyrtim paraprak dhe problem kemi pasë te Drejtoria e administratës, që ka shprehë një shqetësim lidhur me emërtimin e vendbanimeve. Në bazë të Ligjit për kufijt administrativ ndryshon emërtimi i vendbanimeve nga ai i regjistrimit civil dhe kjo ka qenë dilemë se si të veprojmë. Mirëpo, MAPL-ja, na është përgjegjëse se duhet të bazohemi në Ligjin mbi kufijt administrativ.

Hysni Mjeku – Unë e vlerësoj shumë punën e Komisionit dhe znj.Drita Hashani që kujtoj se meriton një lëvdatë sepse Statuti si akt më i lartë normativ kërkon ndryshime në çdo përbërje të re me pasë edhe ndryshime të reja.

Kryesuesi – Unë e kam një kërkesë për znj.Drita Hashani, që çdo herë me qenë prezentë në mbledhjet e Kuvendit komunal, në mënyrë që kur i marrim vendimet e Kuvendit me na ndihmue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal Shqyrtimi i draft Statutit të Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet raportin e Komisionit komunal sipas vendimit nr.I-170, a) raporti nr.X-1054, të dt.04.11.2019 dhe b) raporti nr.X-1087, të dt.11.11.2019. Ky ka qenë Komisioni komunal për ndarjen e bursave të SHM dhe shpenzimet e udhëtimit sipas Rregullores së vjetër.

Fatmir Bektashi – Unë i kam disa pyetje për drejtorin e Arsimit, por që tash nuk është prezent dhe kishte me qenë mirë nëse, ka mundësi me thirrë përndryshe mbetet të vazhdojmë në Kuvend.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për harmonizimin e pagave në Komunën e Obiliqit dhe ia dha fjalën drejtoreshës për sqarim detal.

Zarife Behluli – Neve, nga Ministria e financave na ka ardhë emaili se duhet ta bëjmë harmonizimin e pagave për muajin nëntor dhe dhjetor në ato Drejtori komunale, ku ka pasë tepriçë të mjeteve buxhetore është dashur me i mbulue Drejtoritë të cilat kanë pasë mungesa të mjeteve buxhetore, në emër të pagave dhe meditjeve. Te Drejtoria e

inspeksionit kanë qenë 8,566.58 €, dhe këto mjete janë shpërndarë te administrata komunale, te Zyra e Kryetarit dhe te ZKKK-ja, te Prokurimi 13,000 €, te shërbimet kadastrale 10,000 €, te bujqësia 1,172.05. Këto, mjete kanë shkue në Drejtorinë e financave. Te ambienti 23,538.71, dhe këto mjete kanë shkue në Zyren e Kuvendit 9,783.56. Te Drejtoria e infrastrukturës 11,733.36 €, dhe te administrata e shëndetësisë 2,021.79 €. Te Arsimi fillor 61,068.59 €, këto mjete kanë shkue te kujdesi primar shëndetësor 59,208.77 €, dhe te Arsimi i mesëm 1, 859.82 €. Në total transferi i mjeteve është 117,345.93 €.

Kryesuesi – Pyeti se a është kjo brenda kodit të pagave dhe meditjeve.

Zarife Behluli – Përgjegjet po.

Kryesuesi – Pyeti pse mungojnë 8,000 €, te zyra e Kuvendit sepse e di se me buxhet i kemi rritë afër 4000-5000 €, si do të jetë çështja e rritjes së pagave të anëtarëve të Kuvendit sipas ligjit të ri.

Zarife Behluli - Përgjegjet se ky transfer i mjeteve është brenda masës së pagave, që ne e kemi pasë me buxhet për vitin 2019, ndërsa pagat me rritje i mbulon Ministria e financave dhe kjo s'ka të bëjë me neve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal rialokimi i mjeteve në shumën prej 117,345.93 €.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga Pajazit Dedinca, nga fshati Lajthishtë për fëmijun e tij me autizëm që ti mundësohet transporti i udhëtimit nga Lajthishta në Prishtinë.

Fatmir Bekteshi - Këtu, është një gabim sepse është një problem që nuk janë evidentue në këtë Rregulloren që e kanë bërë për kategoritë e ndryshme psh personat që janë me nevoja te veçanta për me i nxjerrë shpenzimet e rrugës. Komisioni e ka pasë problem me i përcaktue. Poashtu, edhe një rast është në Breznicë, me autizëm që edhe ai nuk ka përfitue. Pra, kanë aplikue dhe i kanë refuzue sepse nuk i kanë specifikue në Rregullore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa nr.I-37745, e dt.13.11.2019 do të trajtohet në Këshillin e drejtorëve dhe DKA, pastaj të vijë në Kuvend me rekomandim.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga N.N.R. Rukolli sh.p.k. për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa nr.I-37638, e dt.12.11.2019 do të trajtohet në Drejtorinë për bujqësi dhe zhvillim rural.

Pika 8 e rendit të ditës


Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rekomandimet e KPF-së, të dt.28.10.2019 lidhur me kërkesat për emërimë të rrugëve dhe me përgjegjet e DPUKP-së. Poashtu, i njoftoi të pranishmit për aprovimin e kërkesës nga DSHMS-ja, rekomanduar nga Kuvendi komunal Komisionit për ndarjen e subvencioneve.

Fatmir Bekteshi – Te çështja e subvencioneve për transport nëse, është këtu prezent dikush nga Arsimi kam një pyetje. Dua të di, sa është pagesa mujore për një nxënës në relacionin Breznicë-Obiliq, ose Breznicë-Prishtinë. Poashtu, e kam një pyetje për drejtorin e infrastrukturës, që me dalë në rr."Mursel Bekteshi" dhe paramasat në atë rrugë janë 40 cm zhavorr me qenë aty. Ne dje e kemi matë dhe kam qenë edhe vetë personalisht aty, mungojnë 12 - 13 cm zhavorr. Këtu, menaxheri i projektit ose drejtori i infrastrukturës sot duhet urgjentë të shkoj.

Te subvencionet e nxënësve i kemi pasë disa thirrje se jemi pak rreth më i gjerë, i kanë anashkalue nxënësit që shkojnë në shkollën "Dituria" në Orloviq, nuk përfitojnë subvencione dhe Grabofcin e kanë anashkalue.

Kryesuesi – Sqaron se nuk ke qenë në mbledhje sepse kjo çështje është diskutuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit. Ne me vendim të veçantë çështjen e Grabofcit e kemi zgjidhë dhe do ta zgjidhim edhe çështjen e Mazgitit. Për pyetjet konkrete ne mund ti ftojmë drejtorët përkatës të na japin sqarime. Sa i përket pyetjes së parë pagesa mujore e udhëtimit është 15 €, ndërsa te rr."Mursel Bekteshi" Ekzekutivi për këtë arsye po e bën punën e vet transparente, po ua jepë paramasat dhe paralogaritë banorëve, Këshillave të fshatrave dhe asambleistëve, që me monitorue.

Procesmbajtese


Azize Zeneli

Mbledhja përfundoi në ora 11:00



Kryesuesi i KPF-së


Burim Gërguri